



abemigrant.com

intervista



## Lajme / News

### THEMELIM I INSTITUTIT ZVICERAN TË STUDIMEVE SHQIPTARE -ISEAL

#### ISEAL

Institut Suisse d'Etudes Albanaises

Istituto Svizzero per gli Studi albanesi

Instituti Zvicceran i Studimeve Shqiptare

Schweizerisches Institut für albanische Studien

#### DOKUMENT SHTYPI

20 prill 2010

### THEMELIM I INSTITUTIT ZVICERAN TË STUDIMEVE SHQIPTARE (ISEAL)

#### Konteksti shoqëror

Në Zvicër jetojnë rreth 270.000 veta me origjinë shqiptare, prej të cilëve më tepër se 100.000 janë të moshës nën 16 vjeç\*. Pas italianëve, bëhet fjalë për komunitetin e dytë të huaj më të madh në Zvicër. Popullsia shqiptare paraqet tipare të ndryshme e të larmishme: ka prejardhje nga disa vende (shumica nga Kosova, por edhe nga Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Shqipëria), dallohet me përkatësi të ndryshme fetare (myslimanë, bektashinj, katolikë, ortodoksë, dervishë etj.), ka prejardhje shoqërore të shumëfishtë si dhe me dialekta të larmishme (toskë, gegë).

Në Zvicër, institucionë dhe shoqata të shumta tregojnë interesim për komunitetin shqiptar në një formë apo në një tjetër. Mirëpo, asnjëra prej tyre nuk e studion dhe nuk pasqyron komunitetin shqiptar në tërësi. Kjo është arsyja që me emrin *Instituti Zvicceran i Studimeve Shqiptare* (ISEAL), formohet një fondacion, në bazë të neneve 80 e në vazhdim të Kodit Civil Zviceran.

Kurorëzim i punës disavjeçare, aktet normative të ISEAL-it janë miratuar zyrtarisht nga anëtarët themelues më 8 dhjetor 2007 në Lozanë dhe janë pranuar nga autoritetet federale më 25 mars 2008.

Selia e ISEAL-it është në Lozanë, ndërsa aktivitetet e tij do të zhvillohen në tërësinë e territorit helvetik. Fondacioni ISEAL ndjek qëllime me vlerë publike, duke përfashtuar çdo qëllim përfitimi.

**Partënerët e ardhshëm:** ISEAL tashmë ka marrë kontakte premtuese me partnerë të numërt institucionesh dhe shoqatash, si në Zvicër ashtu edhe në Shqipëri dhe Kosovë.

**Shoqata e Migve të ISEAL-it: (aA@ISEAL):** Para fillimit të veprimtarive të ISEAL-it, është themeluar një shoqatë e miqve të ISEAL-it: aA@ISEAL nga më tepër se 124 (njëqind e njëzet e katër) personalitete shqiptare, zvicerane dhe të kombeve të tjera. Kjo shoqatë do t'i ketë dyert të hapura për të gjitha e të gjithë personat që dëshirojnë të mbështesin ISEAL-in, por edhe të zhvillojnë aktivitete që shkojnë në drejtim të synimeve dhe qëllimeve të ISEAL-it.